

TURIZMI NË SHIFRA

SHQIPËRI 2021

"Udhëtimi prej një mijë kilometrash fillon me një hap të vetëm."



TURIZMI NË SHIFRA
Shqipëria 2021

Drejtor botimi: Elsa Dhuli
© Copyright INSTAT 2022
Ndalohej riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi
i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me
shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Design: Gentian Suçi

TURIZMI NË SHIFRA

SHQIPËRI 2021

Parathënie

Instituti i Statistikave (INSTAT), boton për të pestin vit radhazi një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi turizmin në Shqipëri. Duke iu referuar vitit 2021, statistikën në lidhje me turistët e huaj dhe vendas në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e turizmit në vendin tonë.

Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative dhe dy anketave: “Pushime dhe Udhëtime” dhe “Anketa e Strukturave Akomoduese”.

Anketa e Turizmit në Familje, “Pushime dhe Udhëtime” është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri mbi 15 vjeç.

Anketa e Strukturave Akomoduese është një vërtetim statistikor që kryhet pranë ndërmarrjeve dhe ka për objekt të gjitha strukturat akomoduese që ofrojnë akomodim afatshkurtër për vizitorët në Shqipëri.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore që do të shërbenin për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat e së ardhmes.

INSTAT gjithmonë do të ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim.

Dr. Elsa DHULI

Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT



PËRMBAJTJA

HYRJE

1	KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË UDHËTIMEVE TË POPULLSISË BANUESE NË SHQIPËRI	11
	Udhëtimet sipas qëllimit	12
	Udhëtimet sipas destinacioneve	12
	Karakteristikat e udhëtimeve	13
	Profili i udhëtarëve	13
	Format e rezervimit	13
	Vendi i origjinës së udhëtimeve	13
2	KARAKTERISTIKAT E VIZITORËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI	15
	Të huaj që kanë hyrë në vend	15
	Rrugët hyrëse	16
	Vizitorë me netë qëndrimi	17
	Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit	17
3	KAPACITETET AKOMODUESE	19
	Shtimi i kapaciteteve akomoduese	19
4	NDIKIMI I TURIZMIT NË EKONOMI	21
	Numri i vizitorëve të huaj për të punësuar	21
	Vlera e shtuar e industrive të lidhura drejtpërdrejt me turizmin	21
5	AKTIVITETE TË TJERA TURISTIKE	23
	METODOLOGJIA	24



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



**SHQIPËRIA ËSHTË E
PARAPËLQYER MË SHUMË NGA
TURISTËT KOSOVARË.**



**GATI GJYSMA (57 %) E VIZITORË
TË HUAJ VIJNË NË TREMUJORIN
E TRETË.**



**NJË VIZITORË I HUAJ KA
QËNDRUAR MESATARISHT
3 NETË NË STRUKTURAT
AKOMODUESE.**



**RRETH 8 NGA 10 SHTETAS TË
HUAJ HYJNË NË SHQIPËRI ME
RRUGË TOKËSORE.**



**AFËRSISHT 47 % E TË HUAJVE
QË KANË HYRË NË VENDIN
TONË GJATË VITIT 2021, KANË
ARDHUR PËR PUSHIME.**





Në vitin 2021, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi brenda vendit ishte rreth 3,13 milionë.

Udhëtimet për qëllime personale përbëjnë 97,9 % të udhëtimeve.

Ndërkohë udhëtimet për qëllime biznesi 2,1 % të tyre.



VLORE

TIRANA

Në vitin 2021, numri i hyrjeve të shtetasve të huaj për qëllime personale është rritur me 2,2 herë, krahasuar me një vit më parë.

Destinacionet më të preferuara për udhëtime (personale apo biznesi) në Shqipëri janë: Tiranë, Vlorë dhe Korçë.

Në udhëtimet e kryera në Shqipëri: 52,0% e udhëtarëve janë meshkuj dhe 48,0% janë femra.

KORÇË

Udhëtarët e grup-moshës 25-34 vjeç kanë regjistruar përqindjen më të lartë të udhëtimeve të kryera brenda vendit, 23,3%.



HYRJE

Industria e turizmit zë një vend kyç në ekonomi dhe është një burim i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Turizmi mund të japë një kontribut të rëndësishëm në tre dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm: të krijojë vende pune, të gjenerojë mundësi tregtare për të njohur nevojat dhe për të mbështetur aktivitete turizmi, të krijojë kapacitetet të rëndësishme të cilat promovojnë përparësitë për ruajtjen mjedisore dhe larminë kulturore.

Prodhimi i statistikave të harmonizuara me ofertën dhe kërkesën e turizmit, sot konsiderohet si vendimtar për t'u mundësuar vendimmarrësve të vlerësojnë dhe përmirësojnë këtë sektor të rëndësishëm ekonomik.

Ky material i përgatitur nga INSTAT përfshin të dhëna për vitin referencë 2021 dhe është publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga 5 kapituj.

1

Kapitulli i parë paraqet karakteristikat e udhetimeve për popullsinë banuese në Shqipëri, sipas qëllimit të udhetimeve, sipas destinacioneve, etj.

2

Kapitulli i dytë paraqet karakteristikat e hyrjeve të shtetasve të huaj sipas rajoneve, mënyrës së udhëtimit, netë qëndrimeve dhe qëllimit të vizitës.

3

Kapitulli i tretë fokusohet në kapacitetet akomoduese në Shqipëri, duke dhënë informacion mbi numrin e njësive akomoduese, numrin e dhomave gjithsej dhe numrin e shtretërve.

4

Kapitulli i katërt paraqet disa tregues makroekonomik si vlerën e shtuar dhe numrin e punonjësve të aktiviteteve që lidhen direkt me turizmin.

5

Kapitulli i pestë përshkruan aktivitete të tjera turistike ku përfshihen muze, parqe arkeologjike, kala dhe monumente të tjerë.





1


KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË UDHËTIMEVE TË POPULLSISË BANUESE NË SHQIPËRI

Në vitin 2021, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi brenda vendit, të kryera nga individët banues në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç ishte 3.122.456. Numri mesatar i netëve të qëndrimit për udhëtime të kryera është 3,33 netë. Udhëtimet për qëllime personale përbëjnë 97,9 % të udhëtimeve gjithsej, ndërkohë udhëtimet për qëllime biznesi 2,1% të tyre.

Përqëndrimet më të larta të udhëtimeve brenda vendit (personale dhe biznes), për vitin 2021 sipas muajit të nisjes janë regjistruar në muajt: Gusht (18,6 %), Korrik (12,1 %), Qershor (11,7 %) dhe Dhjetor (10,1 %).




Shpërndarja e udhëtimeve




UDHËTIMET SIPAS QËLLIMIT

Në vitin 2021, janë regjistruar 7,72 % më shumë udhëtime për pushime dhe kohë të lirë në Shqipëri, krahasuar me vitin 2020. Përgjithësisht është shënuar rritje për të gjitha llojet e udhëtimeve, ndërsa për udhëtimet për qëllime të tjera të kryera në Shqipëri është shënuar ulje.




UDHËTIMET SIPAS DESTINACIONEVE

Përqindjet më të larta të udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi, në vitin 2021 janë regjistruar në qarqet:



Në vijim janë paraqitur përqindjet e udhëtimeve për qëllime personale dhe biznesi në qarqet e Shqipërisë.



KARAKTERISTIKAT E UDHËTIMEVE

Lidhur me udhëtimet e kryera në Shqipëri për qëllime personale apo biznesi:

3,33 netë mesatare qëndrimi



43,87 % akomodohen te të afërm/miq




99,86 % kryhen me transport rrugor





VENDI I ORIGINJËS SË UDHËTIMEVE

33,5 % e udhëtimeve si vend origjinë kanë qarkun e Tiranës, 10,9 % qarkun e Korçës, 8,4% qarkun e Fier, dhe 8,2% qarkun e Elbasan.



PROFILI I UDHËTARËVE

Shpërndarja e udhëtimeve sipas grup-moshës dhe gjinisë:



48,0 % e udhëtarëve femra

52,0 % e udhëtarëve meshkuj

FORMAT E REZERVIMIT

Në rezervimet e kryera nëpërmjet internetit, vihet re se: për rezervimet mbi llojin e transportit përqindjet më të larta regjistrohen për udhëtimet të cilat kanë si destinacion qarkun Vlorë (41,5 %).

Ndërkaq përqindjet më të larta të rezervimeve mbi format e akomodimit me agjensi udhëtimi apo operator paraqiten në udhëtimet që kanë si destinacion qarkun Vlorë (36,5 %) dhe Korçë (18,0 %).



2

KARAKTERISTIKAT E VIZITORËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI




TË HUAJ QË KANË HYRË NË VEND

Në vitin 2021, hyrjet e shtetasve të huaj në Shqipëri kanë qenë afërsisht 5,7 milionë persona. Gjatë vitit 2021, hyrjet e shtetasve të huaj janë 2.1 herë më shumë se viti 2020.

Gjatë vitit 2021, hyrjet e shtetasve nga rajoni i Evropës zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj me 90,9 %. Numri i tyre është rritur me 97,7 %, krahasuar me një vit më parë.

Shtetasit e huaj që hyjnë në Shqipëri vijnë kryesisht nga këto shtete:







Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e
Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

RRUGËT HYRËSE

Sipas rrugëve hyrëse në vitin 2021: Me rrugë ajrore kanë mbërritur afërsisht 765 mijë shtetas të huaj, duke u rritur me 2,8 herë, krahasuar me një vit më parë. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave ajrore zënë mesatarisht 13,4 % të hyrjeve gjithsej

Numri i shtetasve të huaj që mbërrijnë në Shqipëri me linjat detare ka qënë afërsisht 206 mijë duke u rritur me 3,2 herë, krahasuar me një vit më parë. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave detare zënë mesatarisht 3,6 % të hyrjeve gjithsej.

Numri i shtetasve të huaj që mbërrijnë në Shqipëri nëpërmjet tokës ka qënë afërsisht 4,7 milionë duke u rritur me 2,0 herë, krahasuar me një vit më parë. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet tokës zënë pjesën më të madhe me 82,9 % të hyrjeve gjithsej.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

VIZITORË ME NETË QËNDRIMI

Në vitin 2021, numri i vizitorëve të huaj me netë qëndrimi (ku përfshihen vizitorët që qëndrojnë të paktën një natë në hotel apo në struktura akomoduese të tjera, tek të afërmit, shtëpitë e tyre, etj) është rreth 5,3 milionë duke u rritur me 2,1 herë krahasuar me një vit më parë. Ndërsa numri i vizitorëve ditorë është rreth 174 mijë duke u rritur me 3,2 herë krahasuar me një vit më parë.



**93,9 % VIZITORË
ME NETË QËNDRIME**
5.339.905 vizitorë



**3,1 %
UDHËTARË
TRANZIT**
174.817 vizitorë


**3,0 %
VIZITORË
DITORË**
173.927 vizitorë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

HYRJET E SHETASVE TË HUAJ SIPAS QËLLIMIT

Në vitin 2021, hyrjet e shtetasve të huaj për qëllime personale (pushime, vizitë në të afërm, trajtim shëndetësor, qëllime fetare etj) zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj, mesatarisht 98,2 %. Numri i hyrjeve të shtetasve të huaj për qëllime personale është rritur me 2,2 herë, krahasuar me një vit më parë. Ndërsa hyrjet për qëllime biznesi zënë 1,8 % të hyrjeve gjithsej, duke rënë me 13,1 %, krahasuar me vitin 2020.



Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Përshkrimi	2020	2021
1+2 Hyrjet (gjithsej)	2.657.818	5.688.649
1 Personale	2.542.494	5.588.400
1.1 Pushime	1.162.016	2.643.848
1.2 Të tjera qëllime personale	1.380.478	2.944.552
2 Biznesi dhe profesionale	115.324	100.249

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT




3 KAPACITETET AKOMODUESE

Në vitin 2021, në gjithë vendin funksionuan 1.457 struktura akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afatshkurtra) dhe janë vënë në dispozicion rreth 41 mijë dhoma dhe rreth 98 mijë shtretër.

Gjatë vitit 2021, industria e turizmit ka ofruar mesatarisht:

- rreth 35 shtretër në dispozicion të 1.000 banorëve;
- 64 % e shtretërve janë shfrytëzuar (netë qëndrime) nga jo-rezidentët;
- kapacitetet maksimale janë vënë në dispozicion gjatë muajit Gusht (rreth 34 mijë dhoma dhe 83 mijë shtretër);
- tremujori i tretë ka patur normën e shfrytëzimit më të lartë të shtretërve, rreth 36,6 %.

Netë qëndrime gjithsej	Netë qëndrime nga rezident	Netë qëndrime nga jo-rezident
3.186.072	1.155.185	2.030.887



2.829.741
POPULLSIA (VITI 2021)

98.000
SHTRETËR

35
SHTRETËR/1000
BANORË

Burimi: INSTAT, Anketa e Strukturave Akomoduese

www.instat.gov.al



SHTIMI I KAPACITETEVE AKOMODUESE



Gjatë vitit 2021, janë miratuar gjithsej 33 leje ndërtimi për ndërtim hotelesh, nga 23 leje të miratuara në vitin 2020.

Numri i lejeve për ndërtim hotelesh

Përshkrimi	2020	2021
Nr. i lejeve për ndërtim hotelesh	23	33
Sipërfaqe (000/ m ²)	77	144
Vlera e përafërt (milionë Lekë)	2.915	5.183

Burimi: INSTAT, Lejet e ndërtimit

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtim hotelesh, në vitin 2021, është rreth 144.000 m², duke shënuar një rritje prej 87,0 % krahasuar me vitin 2020.


Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit e miratuar për ndërtim hotelesh, në vitin 2021, është rreth 5,1 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 77,8 %, krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, qarku Korçë shënoi numrin më të lartë në lejet e miratuara për "Hotele dhe të ngjashme" me rreth 27,2 % të lejeve gjithsej në nivel vendi.



4

NDIKIMI I TURIZMIT NË EKONOMI



NUMRI I VIZITORËVE TË HUAJ PËR TË PUNËSUAR

Gjatë vitit 2021 në vendin tonë erdhën rreth 5,7 milionë shtetas të huaj. Çdo i punësuar në aktivitetet e lidhura direkt me turizmin (NVE Rev.2. 2-shifrore 55; 56; 77; 79) i shërbente dhe kujdesej për rreth 106 vizitorë të huaj.



VLERA E SHTUAR E INDUSTRIVE TË LIDHURA DREJTPËRDREJT ME TURIZMIN

Vlera e shtuar e industrive të turizmit është rritur me 36,9 %, krahasuar me vitin 2020.

Pesha që zënë industritë e lidhura drejtpërdrejt me turizmin në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2021 është 3,1 %.



	2020	2021 *
INDUSTRITË E TURIZMIT	42.410	58.043
 NVE 55 – AKOMODIMI	10.234	17.545
 NVE 56 – SHËRBBIME USHQIMI DHE PIJE	24.655	26.522
 NVE 77; 79 – AGJENCI UDHËTIMI, OPERATOR TURISTIK DHE TË TJERA	7.521	13.976


Burimi: INSTAT, Rritja Ekonomike Tremujore
* Të dhëna paraprake



5 AKTIVITETE TË TJERA TURISTIKE

Në vitin 2021, numri vizitorëve shqiptarë dhe të huaj që kanë vizituar muzetë, dhe kala e monumente të tjerë ka qenë afërsisht 424 mijë persona duke u rritur me 2,2 herë krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, numri i vizitorëve që kanë vizituar kala e monumente të tjerë është rreth 150 mijë duke zënë 35,4 % të numrit të vizitorëve gjithsej që kanë vizituar institucione të trashëgimisë kulturore, ndjekur nga numri i vizitorëve në parqet arkeologjike që zënë 33,4 %.



Burimi: INSTAT, Statistikat e kulturës



METODOLOGJIA

Anketa e Turizmit në Familje, “Pushime dhe Udhëtime” është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri mbi 15 vjeç. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda/jashtë vendit të ndarë në katër tremujorë përkatësisht: Tremujori i parë (Janar-Mars), tremujori i dytë (Prill-Qershor), tremujori i tretë (Korrik-Shtator), tremujori i katërt (Tetor-Dhjetor). Anketa e Turizmit në Familje, “Pushime dhe Udhëtime” u krye për herë të parë në vitin 2017 përgjatë gjithë vitit me një kampion përfaqësues për të gjithë Shqipërinë.

Anketa e Strukturave Akomoduese monitoron aktivitetet turistike, llogarit treguesit statistikor mbi ofertën akomoduese të turizmit shqiptar, që janë të rëndësishëm për të përcaktuar tendencën e zhvillimit të kapaciteve të sektorit të turizmit. Të dhënat mbledhen çdo muaj nëpërmjet pyetësorit “Anketa e Strukturave Akomoduese”.

Strukturë akomoduese në statistikat e akomodimit janë të gjitha institucionet e akomodimit turistik që ofrojnë, si një shërbim të paguar (megjithëse çmimi mund të subvencionohet pjesërisht ose plotësisht), shërbime akomodimi afatshkurtër ose qëndrimi të shkurtër. Strukturat akomoduese turistike klasifikohen sipas grupeve 55.10; 55.20 dhe 55.30 të klasifikimit NVE Rev. 2.

Përkufizime:

Turizmi është veprimtaria e vizitorëve duke ndërmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vend-banimit të zakonshëm ku jeton, për më pak se një vit, për çfarëdo qëllimi kryesor, duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekti rezident në vendin e vizituar.

Vizitor është klasifikuar një turist (ose vizitori për një ose më shumë netë), në qoftë se udhëtimi i tij / saj përfshin një qëndrim me fjetje.

Vizitor një ditor është një udhëtar ose turist i cili nuk qëndron gjatë natës në vendin ku ka udhëtuar.

Udhëtar do të konsiderohet individ i cili lëviz në vendeve të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje.

Udhëtimi i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.

Turizëm i brendshëm, përfshin aktivitetet e një vizitori rezident brenda vendit.

Turizëm i jashtëm, përfshin aktivitetet e një vizitori rezident jashtë vendit të referencës.

Udhëtim për qëllime personale: Udhëtime për qëllime personale janë ato udhëtime jashtë vend-banimit të zakonshëm të individit, të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj.

Udhëtim për qëllime biznesi ose pune: Udhëtime për qëllime biznesi janë ato udhëtime jashtë vend-banimit të zakonshëm të individit, të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj (kongrese dhe konferenca, panairë dhe ekspozita, bisedime për biznes dhe misione (shitje ose blerje), udhëtime profesionale

(të ndërrmarra nga përfaqësuesit e kulturës apo religjionit, etj). Trajnimin, shoqërimin e personave të tjerë, etj).

Destinacioni kryesor: në rastin e një udhëtimi jashtë vendit, individit deklaron se ku ka qëndruar. Në qoftë se udhëtari nuk është në gjendje për të vendosur, udhëtari do vendosë si destinacionin kryesor vendin ku ai ka shpenzuar kohën më të madhe të netëve të qëndrimit; në qoftë se ka shumë vende me numër të njëjtë të qëndrimeve me fjetje atëherë do vendoset destinacioni më i largët apo vendi ku udhëtari ka shpenzuar më shumë para.

Netët e qëndrimit: janë netët e qëndrimit në një hotel ose ambjent i ngjashëm, në një banesë private me qira ose jo me qira (akomodimi ofrohet nga miqtë apo të afërmit), ose në natyrë (kamping). Gjithashtu në netët e qëndrimit janë të përfshira netët e kaluara në mjetet e udhëtimit (në tren, autobus).

Kohëzgjatja e udhëtimit: Numri i netëve të qëndrimit.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Norma e shfrytëzimit të shtretërve =

$$\frac{\text{Numri i netë qëndrimeve}}{\text{Numri i shtretërve të disponueshëm}} * 100$$

që mat përqindjen e shfrytëzimit të shtretërve për "Hotelet dhe akomodime të ngjashme".

Dhomë fjetje: në një strukturë akomodimi apo banesë është njësia e përbërë nga një dhomë ose grupe dhomash të cilat janë të marra me qira nga vizitorët (turistët) si një e tërë (qira e pandashme).

Shtrat: numri i shtretërve në një godinë akomodimi turistik përcaktohet nga numri i personave që mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përjashtuar shtretërit ekstra të vendosur sipas kërkesës së vizitorit.





TURIZMI NË SHIFRA

SHQIPËRI 2021